



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-38597

Me datë: 16.07.2024

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit, Nr.-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008, e në mbështetje të nenit 44, lidhur me nenin 49 të Ligjit Nr. 05/ L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016", nenit 23, paragrafi 1 të Ligjit të Punës Nr, 03/1-212 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr, 90 / 01/12/2010, nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 Për orarin e punës, pushimet dhe vijushmërinë e zyrtarëve publik, nenit 30 dhe 49 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës merrrë këtë:

V E N D I M

- I. Obligohen shërbyesit civil dhe qendra për shërbime të përbashkëta në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Komunës së Suharekës të punojnë nga ora 8:00 deri në ora 17:00 për periudhën kohore nga data 16.07.2024 deri me datë 30.08.2024.
- II. Obligohet Zyra e Personelit në Komunën e Suharekës, që kompensimin e shërbyesve civil në kuadër të Drejtorisë së Administratës dhe qendrës për shërbime të përbashkëta ta bëjë konform Ligjit Nr. 08/L-196, për Pagat në Sektorin Publik, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 1/2023", nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 Për orarin e punës, pushimet dhe vijushmërinë e zyrtarëve publik dhe nenit 7, paragrafit 2 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Të njoftohen:

- D.A.;
- Q.Sh.P.
- Arkivi.

Kryetari i Komunës



Bali MUHARREMAJ

